

# Ruajtja e Biodiversitetit në Lagunën e Patokut dhe Lumenjve Ishëm dhe Mat

Masa të qëndrueshme me qëllim nxitjen e biodiversitetit në këtë zonë të rëndësishme, nëpërmjet një Menaxhimi të Integruar të Pellgut të Lumit

## Konteksti

Laguna e Patokut dhe ujërat midis lumit Mat dhe lumit Ishëm janë nga "pikat e nxehta" më të rëndësishme në biodiversitetin e Shqipërisë dhe Europës Jugore, e njohur në nivel rajonal si oaz unik për specie e kafshë shumë të rrezikuara. Ajo është një nga Zonat e Veçanta të Mbrojtura në Shqipëri, e identifikuar nga UNEP që në 1996. Ajo është një nga zonat ligatinore më të rëndësishme për zogjtë shtegëtarë dhe një nga dy vendet e rajonit ku është regjistruar deri më tani prezenca e kojlikut, një specie kjo shumë e rrallë. Laguna është gjithashtu një vend i rëndësishëm për ushqimin e breshkave të ujit në Mesdhe.

## Një Parajsë në Rrezik

Nga ana tjetër, edhe pse ka statusin ligjor e Rezervës Natyrore të Menaxhuar, Biodiversiteti në Patok është aktualisht nën një kërcënim të rënd. Reduktimi i mbetjeve të sedimenteve të lumenjëve Mati dhe Ishëm për shkak të digave të hidrocentraleve (Ulëz dhe Shkopet) dhe digës së ujësjellësit (rezervuari i Bovillës), si dhe shfrytësimi i plazhit dhe zhavorrit nga dy lumenjtë dhe degët e tyre, ka ndikuar në masë të madhe në gjeomorfologjinë bregdetare dhe stabilitetin e ekosistemit të lagunës.

Të gjitha ujërat e zeza të prodhuara nga një e treta e popullsisë së Shqipërisë, rreth një million banorë, shkarkohen të patrajtuara në lumin Ishëm dhe degët e tij, duke bërë Ishmin një "lumë të vdekur" duke ndryshuar në mënyrë dramatike cilësinë e ujërave. Mbetjet e ngurta janë gjithashtu duke ndikuar në sistemin bregdetar dhe lagunën e Patokut. Mbetjet plastike përfundojnë në aparatën tretës të kafshëve, duke shkaktuar shpesh vdekjen e llojeve të rrezikuara.



## Plani i Menaxhimit të Integruar të Ujërave

Është e dukshme nevoja për masa të integruara dhe të qëndrueshme me qëllim zvogëlimin dhe kontrollin e impaktit të njeriut dhe zhvillimin e biodiversitetit në këtë zonë. Plani i Menaxhimit të Integruar të Ujërave (IWMP) për lumenjtë Mat dhe Ishëm do të ndajë rolet dhe përgjegjësitë mes palëve të interesuara, do të vendosë qëllimet e menaxhimit dhe objektivat, si dhe do të identifikojë veprimet, masat dhe mekanizmat për të siguruar ruajtjen dhe rritjen e biodiversitetit në lagunën e Patokut.

Projekti do të përmbushë këtë qëllim duke arritur tre objektiva, të cilat plotësojnë gjithashtu tre komponentët e projektit:

- Vlerësimi i statusit aktual të biodiversitetit dhe përgatitja e Planit të Menaxhimit të Integruar të Ujërave
- Implementimi i praktikave të mira menaxhuese për të rritur biodiversitetin dhe reduktimin e kërcënimeve nëpërmjet zhvillimit të iniciativave rehabilituese
- Ngritja e vetëdijes të palëve të interesuara, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e përpjekjeve për ruajtje.

## FAKTET KRYESORE

### PARTNERË:

- ✓ Fondacioni Ndërkombëtar për Ruajtjen
- ✓ Shoqata Shqiptare për Mbrojtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve

### KOHËZGJATJA:

Janar 2014 - Qershor 2015

### PËRFITUES:

- ✓ Komunitetet vendore
- ✓ Mjedisi dhe biodiversiteti në Shqipëri

### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane  
Rr. Asim Vokshi, Nd.14  
Hyrja 11, Ap. 56  
Tiranë  
Tel: +355 4 2256840  
E-mail: uri@uri.org.al  
Web: www.uri.org.al

## Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.